

**Normative Act no. 33, dated 15.03.2020**

On Official Gazette no. 37, was published the Normative Act of the Council of Ministers no. 33, dated 15.03.2020 "On Special Administrative Measures During the Infection Period caused by COVID-19" ("Normative Act 33").

The Normative Act 33, under article 3 "Administrative Measures", inter alia provides for the following:

- Entities or individuals which export medicinal and medical equipment without a proper authorization from the Minister of Health may be subject to a penalty ALL 5.000.000 and the seizure of medicinal and or medical equipment. In case of repeated breach this will be accompanied with the suspension of the activity for a period of 6 months;
- Entities or individuals which organize public gathering events may be subject to a penalty ALL 5.000.000;
- The entry of the family members of the patients in the premises of the medical urgency service without the authorization of the Hospital Directorate is subject to a penalty of ALL 500.000. This penalty is imposed toward the individual member of the family and the person in charge with the application of such limitation;
- A penalty of ALL 700.000 is imposed to the following:
 - i. Any citizen who does not declare entering the Republic of Albania from a country affected with COVID-19;
 - ii. Any citizen entering the Republic of Albania from affected countries and who do not self-quarantine himself for a period of 14 days;
 - iii. Any person infected with COVID-19 who does not comply with the obligation to quarantine himself.
- Private or public education institutions and/or kindergartens which do not comply with the obligation to suspend their activity may be subject to a penalty ALL 5.000.000 for education institutions and ALL 1.000.000 for kindergartens. In case of repeated breach this will be accompanied with the suspension of the activity for a period of 6 months;
- Entities or individuals exercising activities in closed entertainment premises for children and young persons, gyms, sport centers, internet centers, and cultural centers which do not comply with the orders of the competent authorities for their suspension are subject to a penalty of ALL 1.000.000. In case of repeated breach this will be accompanied with the suspension of the activity for a period of 6 months;
- Entities or individuals which do not comply with the orders of the competent authorities for the suspension of the activity for bars, restaurant and clubs are subject to a penalty of ALL 1.000.000. In case of repeated breach this will be accompanied with the suspension of the activity for a period of 6 months;



- Postal services should regularly continue their services and should take adequate measures for the limitation of the contact of the public with employees. Breaches of this provision will be subject to penalty of ALL 1.000.000;
- Drivers of vehicles who do not comply with the limitations set out by the competent authorities for the circulation of vehicles in the areas and timeslots defined by the competent authorities, will be subject the suspension of the driving license for a period of 3 years and the seizure of the vehicle;
- The increase of the sale price of food products, medicinal, medical equipment or services compared to their regular price in the foregoing months (for seasonal products in the foregoing years) which are not a result of the increase of the import price are subject to a penalty of ALL 5.000.000 for wholesale traders and ALL 1.000.000 for retail traders. In case of repeated breach this will be accompanied with the suspension of the activity for a period of 6 months;
- All television programs having more than two people in the same studio will be subject to a penalty of ALL 1.000.000 and in case of repeated breach the full or partial blocking of the transmission;
- Drugstores, medicinal traders and or producers to which do not offer services applying the safety criteria set out by the competent authorities will be subject to a penalty of ALL 10.000.000 for wholesale and ALL 50.000 for retail traders. In case of repeated breach all the product quantity will be seized and the activity will be suspended for a period of 3 years;
- Entities/individuals engaged in wholesale and retail of food products which do not offer services applying the safety criteria set out by the competent authorities will be subject to a penalty of ALL 10.000.000 for wholesale and ALL 50.000 for retail traders. In case of repeated breach all the product quantity will be seized and the activity will be suspended for a period of 3 years;
- Depending on the spreading dynamics of COVID-19, in case of necessity, upon order of the Ministry of Health, all private hospitals, health and hotel structures as well as ambulances along with the relevant staff will be placed on the disposal of the patients infected with COVID-19. Failure to comply with such order will be subject to a penalty of ALL 5.000.000 for structure and ALL 100.000 for medical personnel. In case of repeated breach, for the structure will be applied the suspension of the activity and will be forcibly placed into the disposal of the public health service while for medical personnel will be prohibited the exercise of the profession for a period of 10 years.

This Normative Act enters into force immediately and will remain into force during all the time of the infection caused from COVID-19.



Akti Normativ nr. 33, datë 15.03.2020

Në fletoren zyrtare 37, u publikua Akti Normativ nr. 33, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19" ("Akti Normativ 33").

Akti normativ 33 në nenin 3 të tij "Masat Administrative", parashikon sa më poshtë:

- Subjektet që eksportojnë barna dhe pajisje mjekësore nga Republika e Shqipërisë, pa autorizim të posaçëm të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për kryerjen e këtij aktiviteti, dënohen me gjobë në masën 5.000.000 lekë dhe iu sekuestrohet e gjithë sasia e barnave/pajisjeve mjekësore. Në rast përsëritjeje, masave të mësipërme iu shtohet edhe ndalimi i eksportit të barnave/pajisjeve mjekësore, deri në 6 muaj;
- Subjektet apo individët që organizojnë zhvillimin e aktiviteteve publike dhe jopublike dënohen me gjobë në masën 5.000.000 lekë;
- Hyrja e shoqëruesve dhe/ose e familjarëve të pacientëve në ambientet e shërbimit të urgjencës mjekësore, pa autorizim, dënohet me gjobë në masën 500.000 lekë. Ky penalitet i aplikohet shoqëruesit dhe/ose familjarit të pacientit si dhe për personin përgjegjës që ka për detyrë zbatimin e këtij rregulli.
- Dënohet me gjobë në masën 700.000 lekë:
 - i. Shtetasi, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk deklaron ardhjen e tij nga zonat e prekura nga infeksioni COVID-19;
 - ii. Shtetasi, i cili hyn nga zonat e prekura në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk vetëkarantinohet për një periudhë 14-ditore;
 - iii. Shtetasi, i cili ka rezultuar pozitiv dhe nuk zbaton urdhrin e dhënë nga organet kompetente për vetë-karantinimin e detyrueshëm.
- Institucionet arsimore, çerdhet dhe kopshtet, publike dhe jopublike, që nuk mbyllin aktivitetin e tyre për periudhën e përcaktuar dënohen me gjobë në masën 5.000.000 lekë për institucionet arsimore dhe në masën 1.000.000 lekë për çerdhet dhe kopshtet, publike/jopublike. Në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore;
- Subjektet apo individët që zhvillojnë aktivitete në ambientet e mbyllura për fëmijë, të rinj, palestrat, qendrat sportive, pishinat, qendrat e internetit, qendrat kulturore, që nuk zbatojnë urdhrin e organit kompetent për mbylljen e tyre, dënohen me gjobë në masën 1.000.000 lekë. Në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore;
- Subjektet apo individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrat e dhëna nga organet kompetente për mos mbylljen e bareve, lokaleve, restoranteve dhe klubeve dënohen me gjobë në masën 1.000.000 lekë. Në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore;



- Organet e shërbimit postar duhet të garantojnë vazhdimësinë e shërbimit dhe të hartojnë një plan masash për të kufizuar kontaktet e punonjësve me publikun . Moszbatimi i këtij detyrimi dënohet me gjobë në masën 1.000.000 lekë;
- Drejtuesit e automjeteve, të cilët nuk zbatojnë ndalimin e qarkullimit të mjeteve në zonat dhe oraret e përcaktuara nga organet kompetente, dënohen me heqje të lejes së drejtimit për një periudhë tre vjeçare dhe bllokim të mjetit;
- Rritja e çmimit të shitjes të të gjitha mallrave dhe produkteve ushqimore, barnave, pajisjeve mjekësore dhe shërbimeve në krahasim me çmimin e tyre në shitje të rregullt (për produktet sezonale sipas çmimit të tregtuar në të njëjtën periudhë kohore), kur nuk vjen si pasojë e rritjes së çmimit nga importi i tyre, dënohet me gjobë në masën 5.000.000 lekë për tregtuesit me shumicë dhe 100.000 lekë për tregtuesit me pakicë. Në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore;
- Të gjitha transmetimet audiovizive me më shumë se dy persona në të njëjtën studio dënohen me gjobë në masën 1.000.000 lekë dhe në rast përsëritjeje iu shtohet edhe vendosja e bllokimit të pjesshëm ose të plotë të transmetimit;
- Farmacitë, tregtuesit me shumicë të barnave dhe prodhuesit e barnave, të cilët nuk ofrojnë shërbimin e tyre duke zbatuar kriteret e sigurisë të përcaktuara nga organet kompetente, dënohen me gjobë në masën 10.000.000 lekë për tregtuesit me shumicë dhe në masën 50.000 lekë për tregtuesit me pakicë. Në rast përsëritjeje, dënohen me bllokimin e të gjithë sasisë së mallit dhe mbylljen e veprimtarisë për një periudhë trevjeçare;
- Subjektet/individët që tregtojnë produkte ushqimore, me shumicë apo pakicë, të cilët nuk ofrojnë shërbimin e tyre duke zbatuar kriteret e sigurisë të përcaktuara nga organet kompetente, dënohen me gjobë në masën 10.000.000 lekë për tregtuesit me shumicë dhe në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tregtuesit me pakicë. Në rast përsëritjeje dënohen me bllokimin e të gjithë sasisë së mallit dhe mbylljen e veprimtarisë për një periudhë trevjeçare;
- Në varësi të dinamikës së spitalizimit të të prekurve nga infeksioni COVID-19, vendosen në dispozicion edhe strukturat private spitalore, ambulatorë, hoteliere, autoambulancat dhe personeli përkatës, shëndetësor e mbështetës. Moszbatimi i këtij urdhri dënohet me gjobë në masën 5.000.000 lekë dhe në rast përsëritjeje vendoset bllokimi i aktivitetit, duke e vendosur strukturën në dispozicion të shërbimit publik shëndetësor. Moszbatimi i këtij detyrimi nga personeli përkatës, shëndetësor e mbështetës, dënohet me gjobë në masën 100.000 lekë dhe në rast përsëritjeje iu shtohet edhe heqja e të drejtës së ushtrimit të profesionit për një periudhë dhjetëvjeçare.

Aktiv Normativ 33 hyn në fuqi menjëherë dhe do të mbetet në fuqi gjatë të gjithë periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.